



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:063733  
Datë: 26.02.2024  
Numri i dokumentit: 05376821

KPPP.nr.628/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania “FRESH BOXX” Sh.P.K., me adresë Babimoc, Magjistratja Prishtinë-Mitrovicë, me NRB: 811337361, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kosovare Sopi avokate nga Prishtina, kundër debitorit “THE NORTH UNICORN” L.L.C., me adresë Zona Industriale Prishtinë, me NRB: 8100112186, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.145/23 të datës 17.03.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 12.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “THE NORTH UNICORN” L.L.C, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.145/23 të datës 17.03.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

## A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.145/23 të datës 17.03.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturave: faturës nr.10174 të datës 26.12.2022, faturës nr.10333 të datës 31.12.2022, faturës nr.95 të datës 05.01.2023, dhe faturës nr.379 të datës 18.01.2023, duke urdhëruar debitorin që t'ia paguajë kreditorit borxhin në vlerë prej 16,781.98 Euro, në emër të kompensimit të borxhit për furnizimet me pemë dhe perime, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga momenti i dorëzimit të propozimit për përmbarim, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimin për përmbarim e karakterizon parregullësia në përmbajtjen e tij, për faktin se kreditori ka paraqitur si dokument të besueshëm fatura të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën fare, ose nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit si dhe vulën e debitorit, me çka cenon rëndë kredibilitetin dhe bazën ligjore të këtij urdhri përmbarues, duke qenë se në të dhënat e ARBK-së, agjent i regjistruar është B.K., e në fakt në faturat e cekura nënshkrimet janë të panjohura për debitorin. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi si i themeltë prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.145/23 i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit në prapësim, ngase çdo faturë është e vulosur dhe e nënshkruar nga ana e debitorit dhe kreditorit, si dhe propozimit për përmbarim ua kemi bashkangjitur këto fatura origjinale. Tutje ka shtuar se debitori po të mos i kishte pranuar faturat në fjalë, apo po të mos ishte në dijeni për të njejtat, atëherë si i ka evidentuar të njejtat në kartelën financiare të tij. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, dhe i ka kërkuar shpenzimet në emër të përgjigjes në prapësim, në shumën prej 624.00 Euro, sipas tarifës së OAK-së, ku është paraparë se avokatit i takon shpërblimi i dyfishuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm/faturat- faturën nr.10174 të datës 26.12.2022, faturën nr.10333 të datës 31.12.2022, faturën nr.95 të datës 05.01.2023, dhe faturën nr.379 të datës 18.01.2023, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit, pra rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit dhe se në faturat e cekura nënshkrimet janë të panjohura për debitorin, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa gjykata në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.628/23, me datë 12.02.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.